



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 222, datë 22.10.2019

### PËR

### VLERËSIMIN E STATUSIT INDIVIDUAL DHE KARRIERËN PËR ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 283, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes Vendore së Sistemit të Drejtësisë”, në nenin 168, dhe nenin 165 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi Raportin e Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ngritur me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019, të këtij Këshilli, lidhur me inspektoren {...}, në përfundim,

### VËREN

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019 ngriti Komisionin e Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili kishte për detyra të evidentojë:

- a) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve;
- b) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve;
- c) inspektorët të cilët gëzojnë statusin e magjistratit dhe cilët ndër inspektorë nuk e gëzojnë këtë status.
- d) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit;
- e) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet;
- f) dhënia e pëlqimit nga secili inspektorë për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të këtyre detyrave Komisioni i Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë verifikoi dhe konstatoi se:

Inspektorja {...} ka lindur në Durrës, më datë 28.03.1963. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në vitet akademike 1993-1994.

Pas përfundimit të studimeve në drejtësi është emëruar ndihmës/gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.13, datë 24.11.1993 dhe më pas transferohet po si ndihmës/gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.01, datë 30.03.1995, të po këtij Këshilli. *Është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 07, datë 08.02.1996 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

*Znj. {...} është shkarkuar nga detyra e gjyqtares, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 28/1, datë 20.03.1999, me motivacionin: “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”.*

Gjatë periudhës 1999-2003 ka punuar në profesionin e lirë të avokates, pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe më pas është emëruar si specialiste finance në Sektorin e Prokurimeve Publike, pranë Presidencës së Republikës së Shqipërisë.

Me vendimin nr. 312, datë 18.03.2013, ish Këshilli i Lartë të Drejtësisë, e ka emëruar Znj. {...} në detyrën e inspektore, ndërsa me vendimin nr. 36, datë 07.05.2018, të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, asaj i është zgjatur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në bazë të Urdhrit nr. 08, datë 19.04.2013, të titullarit të ish KLD-së mbi ndarjen e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksione, znj. {...} ka mbuluar Seksionin e Vlerësimit Profesional dhe Etik, në procesin e shqyrtimit të vendimeve të cënuara nga gjykatat e niveleve më të larta dhe më pas me Urdhrin nr.1 datë 07.01.2016 në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave. Ndërsa prej muajit Janar të vitit 2019, kryen detyrën e Inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 14 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar është parashikuar se:

- 1. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit dhe numri i inspektorëve përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.*
- 2. Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Zëvendëskryetarit.*
- 3. Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t’u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet.*
- 4. Veprimtaria e Inspektoratit drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

5. Kryeinspektori organizon dhe përgjigjet për veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit.
6. Për Kryeinspektorin dhe inspektorët, jo më pak se një herë në 2 vjet, kryhet vlerësimi profesional dhe etik, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
7. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës. Raporti i përgatitur nga Inspektorati paraqitet nga Zëvendëskryetari për diskutim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ndërsa në nenin 15, të po këtij ligji është parashikuar se:

1. Inspektorët emërohen në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi.
2. Periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Gjyqtarët, që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs.
3. Kryeinspektori përfiton pagë të njëjtë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, ndërsa inspektorët përfitojnë pagë të njëjtë me gjyqtarët e kësaj gjykate.

Nga citimi i fakteve dhe dispozitave ligjore të mësipërme, rezulton se inspektorja {...}, pas shkarkimit nga funksioni i gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më **datë 20.03.1999**, ka punuar në pozicione të tjera jashtë sitemit gjyqësor deri më 18.03.2013, datë kur është emëruar në detyrën e inspektore pranë ish Këshilli të Lartë të Drejtësisë, nga “radhët e juristëve që kanë punuar jo me pak se 5 vjet gjyqtar”.

Gjithashtu, po t’i referohemi ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 28 të tij, ku bën fjalë për ruajtjen e statusit të gjyqtarëve që shërbejnë në institucione të tjera, parashikon se:

1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.
2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.
3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.
4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Të ndodhur përpara këtyre kushteve znj. {...}, nuk mund të rikthehej në vendin e mëparshëm të punës, pasi ajo e ka humbur këtë të drejtë dhe emërimi i saj si gjyqtar mund të bëhej vetëm duke u bazuar në ligjin nr.9877, datë 18.2.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 11 ku referon,

*1. Gjyqtar mund të emërohet shtetasi shqiptar, që përmbush kriteret e mëposhtme:*

*a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*

*b) të jetë me arsim të lartë juridik;*

*c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;*

*ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;*

*d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale.*

*2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të emërojë deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve persona, të cilët kanë punuar më parë gjyqtarë dhe përmbushin kriteret e shkronjave "a", "b", "ç" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni.*

dhe gjithashtu neni 12,

*1. Gjyqtari në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë .*

emërim, të cilin znj. {...} nuk e arritur gjatë kohës së punës si inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pra ndodhemi përpara faktit se, ajo mund të përmbushte kushtet për tu emëruar gjyqtare, por që aktualisht nuk e gëzon statusin e magjistratit.

Në rastin konkret nuk mund t’i referohemi nenit 168, paragrafi 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ku është parashikuar se:

*Inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë , të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ato i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.....*

por duhet t’i referohemi nenit 165, të ligjit 96/2016, i cili specifikon dispozitat kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistrat, pika 1, 4 dhe 9 e këtij neni:

*1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

*4. Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas*

*parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë:*

*a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës;*

*b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim;*

*c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit, të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit.*

*9. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit në detyrë kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjekin fushën e karrierës së magjistratit, kanë të drejtë për t’u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tyre aktual dhe për të cilin përmbushin kriteret. Kërkesa për caktim në pozicion paraqitet respektivisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, brenda një muaji pas publikimit të rezultatit të testimit të Shkollës së Magjistraturës. Në këtë rast marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor, inspektorit dhe këshilltarit të gjyqtarit në detyrë mbaron në ditën e paraqitjes së kërkesës...*

Për sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se, inspektorja {...}, i kishte mundësitë për të konkuruar dhe plotësuar kushtet e përcaktuara sipas nenit 165 të sipercituar, pasi ajo nuk vinte nga radhët e gjyqtarëve në detyrë dhe nuk e dispononte statusin e magjistratit, por zgjodhi të mbate statusin aktual të inspektorit të ardhur nga radhët e jomagjistratëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nenin 283 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenin 165 dhe nenin 168, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë mospasjen e statusit “Magjistrat” për znj. {...}.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**